

ANEKSI 1:

Procedura e Ndryshimeve të Kontratës

Neni 1

Parime të përgjithshme

Ky aneks përcakton procedurën për trajtimin e Ndryshimeve të kësaj Kontrate.

Pa paragjykuar asnjë nga dispozitat e kësaj Kontrate, të dy palët:

- pranojnë nevojën për të vepruar në mënyrë të arsyeshme në të gjitha rastet lidhur me menaxhimin, propozimin, miratimin dhe refuzimin e Ndryshimeve të Kontratës; dhe
- marrin përsipër të veprojnë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me menaxhimin, propozimin, miratimin dhe refuzimin e Ndryshimeve të Kontratës.

Neni 2

Kërkesa për Ndryshim

Secila palë mund t'i bëjë një Kërkesë për Ndryshim palës tjetër në cdo kohë gjatë Kohëzgjatjes së Kontratës. Kërkesa për Ndryshim duhet të jetë me shkrim dhe të përmbajë :

- Datën e paraqitjes si dhe palën që e paraqet atë,
- Detaje të kërkesave të lidhura me Ndryshimin e Kontratës dhe me Dokumentet e Autorizimit të Ndryshimit,
- Draft Projekti që përmban ndryshimet e kërkuara,
- Detaje lidhur me fazat dhe me grafikun e zbatimit,
- Detaje të varësive të tjera (duke përfshirë cdo kontribut të kërkuar nga Pala kërkuese),
- Detaje të produkteve rezultuese për dorëzim,
- Detaje të detyrimeve shtesë individuale dhe të mjeteve për përcaktimin e tyre (për shembull, në bazë cmimi fiks ose kostoje shtesë),

- Data dhe nënshkrimi.



Neni 3

Autorizimi i Ndryshimit

Pala , që merr një Kërkesë për Ndryshim Kontrate , duhet brenda 30 ditësh duhet të kthejë përgjigje në lidhje me propozimin e bërë e cila duhet të përmbaj :

- Autorizimin ose Refuzimin e Ndryshimit të Kontratës,
- Detaje shtesë në lidhje me vendimin (nëse e kërkon),
- Propozime në lidhje me çështjet e shtruara për ndryshim,
- Data dhe nënshkrimi.

Konçesionari nuk mund të zbatoj asnjë Ndryshim të kësaj Kontrate, i përpunuar sipas këtij Aneksi, pa u miratuar dhe nënshkruar në mënyrë të rregullt nga Autoriteti.

Palët duhet të bien dakort edhe në lidhje me datën në të cilën do të hyjë në fuqi Ndryshimi i Kontratës. Në rast se palët nuk kanë parashikuar një datë të tillë, do të konsiderohet si datë e hyrjes në fuqi , data në të cilën është nënshkruar Ndryshimi i Kontratës nga të dyja palët.

Per: "BLUE EYE ONE" Sh.p.k

Për: MINISTRINË E MJEDISIT

Administratore

Zni. Sofie MERKAJ

ANEKSI 6:

Ndryshimi i Kontratës.

Në zbatim të Aneksit 1 të Kontratës Koncesionare me nr. prot. 8618, datë 14.08.2014 të lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Shoqërisë "Blue Eye One" sh.p.k. me objekt "Marrjen me koncesion të burimit uxor Sasaj, Bunec, në Komunën Lukovë, Sarandë", mbi bazë të kërkesës të subjektit "Blue Eye One" sh.p.k. referuar nenit 2 të Aneksit 1, si dhe në kuadër të VKM nr. 92 datë 04.02.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 945, datë 9.10.2013 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mjedisit" dhe VKM nr. 91 datë 4.2.2015 "Për disa shtesa në Vendimin nr. 939, datë 9.10.2013 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave", palët:

Ministrisë së Mjedisit, e Republikës së Shqipërisë (në vazhdim referuar si "**Autoriteti**") e përcaktuar si e tillë me **Vendim I Këshillit të Ministrave, Nr.272**, datë 3 prill 2013, "*Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënje me koncesion të burimit uxor 'Sasaj', dhe miratimin e bonusit , në procedurën përzgjedëse konkurruese , që I jepet shoqërisë 'Blue Eye One' "* ,përfaqësuar nga Z.Lefter Koka, Ministër , Titullari I Autoritetit.

DHE

Shoqërisë 'Blue Eye One' sh.p.k (në vazhdim referuar si '**Koncesioneri**'), e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit me numër serial SN- 110348-01-11, datë 12 janar 2011, me seli në Rrugën Muhamet Gjollësja, Pallati 7, Shkalla 1 , Apartamenti 1, Tiranë, me numër unik identifikimi (NUIS): L 11312027 P, me përfaqësuese ligjore Znj. Sofie Merkaj, shtetase shqipëtare, e bija e Ramadanit, lindur më 17.03.1942., banuese në Tiranë, në cilësinë e Administratorit.

Vendosën dhe ranë dakort me ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 7 i kontratës do të ketë këtë përmbajtje:

"Periudha e Koncesionit

Koncesioni jepet për një periudhë prej 35 vjetësh nga hyrja në fuqi e saj (Data Efektive) dhe përfundon në ditën e përvjetorit të 35-të të Datës Efektive (Periudha Efektive). Megjithatë, në rastin e një Zgjidhjeje përpara afatit 35 vjeçar, Periudha e Koncesionit do të nënkuptojë dhe do të kufizohet tek periudha që fillon nga Data Efektive dhe mbaron në Datën e Zgjidhjes."

Neni 2

Kopjet e hartuara

Ky Aneks kontrate hartohet në gjuhën shqipe në 4 (kater) kopje të cilat kanë të njëjtën vlerë ndërmjet tyre.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ndryshimi i Kontratës së koncesionit (Aneksi 6) do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të palëve në prani të një noteri publik. Në rast se palët nuk kanë parashikuar një datë të tillë, do të konsiderohet nënshkrimi si datë e hyrjes në fuqi.

Për: MINISTRINË E MJEDISIT

Për: MINISTRINË E BUJQËSISË

Per: "BLUE

ZHVILLIMIT RURAL

EYE ONE" Sh.p.k

ADMINISTRIMIN E UJRAVE

Z. Lefter KOKA

Z. Edmond PANARITI

Znj. Sofije MERKAJ